



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 619/1 prot.

Tiranë, më 12 .04 . 2021

**V E N D I M**

**Nr. 58 , Datë 12 / 04 / 2021**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 152, datë 15.12.2020, të paraqitur nga Qendra “T’REJA” kundër S.N, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të etnisë<sup>1</sup>, gjendjes ekonomike dhe përkatësisë në një grup të veçantë, të komunitetit Rom.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues informon se: *“Në emisionin “Shqipëria Live” të datës 14.12.2020, të transmetuar në televizionin Top Channel, S.N është shprehur me një qëndrim fytes për komunitetin Rom. Sipas S.N, personat që kanë dalë në protestë dhe janë të paguar, i përkasin komunitetit Rom dhe kërkojnë shkatërrimin e qytetit. Gjuha e përdorur nga S.N përforcon stereotipet diskriminuese ndaj Romëve si njerëz inferiorë, që mund të përdoren lehtësisht dhe tashmë janë përgjegjës për shkatërrimin e qytetit”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kërkimin e ndjesës publike nga S.N.

<sup>1</sup> Komisioni Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) ka adoptuar një qasje të gjerë duke e përkufizuar “diskriminimin racor” se përfshin “racën, ngjyrën, gjuhën, besimin fetar, shtetësinë, origjinën kombëtare apo etnike”, (ECRI, General Policy Recommendation Nr. 7 on National Legislation to Combat Racism and Racial Discrimination, CRI(2003)8, adopted 13 December 2002, par 1(b).

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Qendra “T’REJA”, është një organizatë jofitimrurëse, regjistruar si person juridik, me Vendimin nr. 1154, datë 16.03.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur Qendra “T’REJA” nuk pretendon se është cënuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtëpërdrejtë, por parashtron se gjuha e përdorur nga ana e S.N në emisionin “Shqipëria Live” të datës 14.12.2020, të transmetuar në televizionin Top Channel, përforcon stereotipet diskriminuese ndaj anëtarëve të komunitetit Rom.

Bazuar në nenin 32/3, të LMD-së përcaktohet se: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”*.

Bazuar në nenin 3, pika 7 dhe 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtëpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi; ose b) një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtëpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, por që të drejtat ose interesat e saj ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës. .... 8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi”*.

Referuar nenit 33/1/2, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person: a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative; b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative; ose c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative. 2. Në procedurën administrative janë gjithashtu palë edhe mbajtësit e interesave publikë të autorizuar me ligj, si dhe mbajtësit e interesave kolektivë apo interesave të gjerë të publikut, nëse këta interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative”*.

Bazuar në këto dispozita ligjore rezulton se kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund ta bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtëpërdrejtë të vetin. Në këtë rast, që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cenohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në statutin e Qendrës “T’REJA”, ajo është një organizatë jofitimrurëse, dhe ka në objekt të veprimtarisë, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore njerëzore dhe në

kuadër të tyre dhe ato të komuniteteve Egjiptiane dhe Rome në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së ankuesit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se ankuesi legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi. Bazuar në nenin 32/1c, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë të kryejë hetime administrative, për shkelje të dispozitave të këtij ligji.

Neni 7 i LMD-së<sup>2</sup>, të ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 152, datë 15.12.2020 të Qendrës “T’REJA”, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1755/1, datë 18.12.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga S.N, lidhur me pretendimin e subjektit ankues, duke e informuar paraprakisht se nëse do të ndërmerreshin masa të menjëhershme lidhur me rregullimin e problematikës, duke kërkuar ndjesë publike ndaj komunitetit Rom, Komisioneri do të ndërpriste procedurën hetimore, duke e konsideruar rastin të zgjidhur.

Me shkresën datë 07.01.2021, të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, S.N informoi se: *“Nuk kam bërë asnjë fyerje, vetëm se kam konstatuar sipas informacioneve të shtypit dhe medias shqiptare, në lidhje me protestën e dhunshme me shkatërrim dhe djegie. Termi rom është status social sot në Shqipëri. Sipas të dhënave të shtypit jam njohur me faktin se, pjesëmarrësit e protestës ishin të mitur romë. Nëse nuk kanë qenë të mitur romë në protestë, duhet të ma konfirmoni që të mbaj qëndrimin tim. Në të kundërt, në qoftë se, në protestën e dhunshme me djegie ka pasur vërtet të mitur romë, siç ka thënë media, atëherë unë nuk ka se çfarë qëndrimi të mbaj, sepse është konstatim i vërtetë”.*

---

<sup>2</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

- Me shkresën nr. 175, datë 25.01.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kërkuar parashtime nga S.N, lidhur me gjuhën e përdorur në emision, pasi identifikimi i fëmijëve Rom si të paguar dhe shkatërrues të pronës publike/private krijon premisa për stereotipizim negativ të komunitetit Rom. S.N ka marrë dijeni për shkresën me anë të Lajmërim Marrje Poste me kodin: RR613559982AA, datë 26.01.2021, por nuk ka kthyer përgjigje.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Sipas informacionit të administruar gjatë procedurës së hetimit, u konstatua që:

- Gjatë emisionit “Shqipëria Live” të datës 14.12.2020, të transmetuar në televizionin Top Channel, S.N është shprehur si vijon: *“Minuta: 04.02. “.....njësoj si të korruptuarit që kanë paguar fëmijët, shumica Romë, për të sjellë shkatërrimin e Shqipërisë....” dhe Min: 07.25. “...mendoni se kanë ardhur vetë fëmijët atje, shumica Romë, të gjithë të paguar, turp i madh.....”*<sup>3</sup>.
- Pavarësisht kërkesave të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të dhënë shpjegimet e tij lidhur me gjuhën e përdorur në emision, duke identifikuar në veçanti fëmijët e komunitetit Rom si të paguar dhe shkatërrues të pronës publike/private, nga ana e S.N nuk u vu në dispozicion asnjë informacion lidhur me shprehjet e përdorura në adresë të komunitetit rom.

Në nenin 1 të Ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Raca, është shkak për të cilin ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ofron mbrojtje nga sjelljet diskriminuese dhe bazuar në nenin 32/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me racën.

<sup>3</sup><https://top-channel.tv/video/s.n-protestuesit-po-shkaterrojne-qytetin-jane-bandite-shqiperia-live-14-dhjetor-2020/>,  
<https://www.youtube.com/watch?v=JihK0NUoTVc&feature=emb>

Ligji 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ka parashikuar në Nenin 7/1 se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”*.

Dinjteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, janë në bazat e shtetit shqiptar. Kjo sanksionohet në nenin 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku sanksionohet se: *“Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë”*.

Liria e shprehjes dhe mendimit, toleranca dhe respekti për dinjtetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore, është thelbësore për një shoqëri demokratike dhe pluraliste. Megjithatë, liria e shprehjes dhe mendimit nuk është një e drejtë e pakufizuar dhe se ajo nuk duhet të ushtrohet në një mënyrë të papajtueshme me të drejtat e të tjerëve. Liria e shprehjes, është një e drejtë Kushtetuese, e cila garantohet nga neni 22/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë<sup>4</sup>. Kushtetuta sanksionon se të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në të mund të kufizohen<sup>5</sup>. Kushtetuta e lidh kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në të, me detyrimin për të mos tejkaluar kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Referuar deklaratave të bëra në emisionin objekt shqyrtimi, S.N ka deklaruar, duke veçuar dhe sjellë në vëmendje të publikut, se gjatë protestave të muajit dhjetor 2020, shumica e fëmijëve që kanë shkatërruar pronën publike dhe private gjatë protestave, kanë qenë fëmijë të paguar, që i përkisnin komunitetit Rom.

Deklarata në fjalë e S.N, paraqet rëndësi të veçantë, për shkak të cilësisë së veçantë të S.N, jo vetëm si Kryetar i subjektit politik “Ligj dhe Drejtësi” apo si ish deputet i Kuvendit të Shqipërisë, por dhe si person publik, që ka impakt në publikun që e ndjek.

Në analizën që i është bërë gjuhës së përdorur në emision, të mbajtur nga S.N, në emisionin e datës 14.12.2020, nëse do të konsiderohet në tejkallim të lirisë së shprehjes të sanksionuar në nenin 22 të Kushtetutës, i jemi referuar kufizimeve që parashikon Konventa për lirinë e shprehjes, të parashikuar në nenin 10 të saj dhe qëndrimin të mbajtur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

---

<sup>4</sup>Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: *“Liria e shprehjes është e garantuar”*.

<sup>5</sup>Neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: *“ Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi. Sipas paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës, ushtrimi i kësaj lirie nuk mund të çenojë dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka theksuar në gjykime të ndryshme se: *“Toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si çështje parimore mund të konsiderohet e nevojshme në disa shoqëri demokratike që të sanksionojnë ose madje të parandalojnë të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen e bazuar në jo tolerancë ..., me kusht që çdo “formalitet”, “kusht”, “kufizimet ose gjokat” janë proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur. (Erbakan v. Turkey, Aktgjykimi i 6 korrikut 2006, § 56)”. Duke qenë kështu lind nevoja e parandalimit të të gjitha formave të shprehjes, të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen bazuar në mungesën e tolerancës. E drejta e individëve, për të shprehur lirisht mendimet e tyre nuk duhet të “fyejë, tronditin apo shqetësojnë” të tjerët<sup>6</sup>.*

Pra, shohim se “fjalimet e urrejtjes” kundër personave që i përkasin komunitetit rom, kanë të bëjnë me të gjitha format e shprehjes, të bëra publike nëpërmjet medias, të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtje, diskriminim apo armiqësi ndaj individëve të këtij komuniteti. Vlerësimi, nëse shprehje të tilla apo deklarata të caktuara do të konsiderohen si “fjalime të urrejtjes”, duhet të bëhen në përputhje me lirinë e shprehjes të garantuar në nenin 10 të Konventës.

Sipas Rekomandimit të Përgjithshëm të Politikave nr. 15 të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për *“Luftimin e Gjuhës së Urrëjtjes”*, gjuha e urrejtjes, sipas formulimit, do të kuptohet si mbrojtje, promovim ose nxitje, në çdo formë, e denigrimit, urrejtjes ose shpifjes ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo ngacmimi, ofendimi, stereotipizimi negativ, stigmatizimi ose kërcënimi në lidhje me këtë person apo grup personash dhe justifikimi i të gjitha llojeve të mëparshme të shprehjes, bazuar në *“racë”*, ngjyrë, prejardhje, origjinë kombëtare ose etnike, moshë, aftësi të kufizuar, gjuhë, fe ose besim, seks, gjini, identitet gjinor, orientim seksual dhe karakteristika të tjera personale ose statuse.

Duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuara në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në referim edhe të evokimit që i bëhet asaj në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë logjike edhe praktika e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilave bëhet interpretimi i Konventës, kanë fuqinë e Konventës.

Komisioneri është i vetëdijshëm se, liria e fjalës në sferën e politikës është e një rëndësie të veçantë. Por, rëndësia që merr liria e fjalës për një person të përfshirë në politikë, ngarkon me një

---

<sup>6</sup> Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, çështja nr. 5493/72, 07.12.1976 - Përkthim i Komisionerit



përgjegjësi më të madhe, e për të treguar më tepër kujdes dhe për të evituar gjuhën që nxit mos tolerancën dhe diskriminimin mes publikut (*shih Erbakan kundër Turqisë, 6 korrik 2006, GJEDNJ*).

Në çështjen në fjalë GJEDNJ-ja, ka mbajtur qëndrimin dhe ka pranuar se diskriminimi i drejtpërdrejtë mund të shfaqet edhe në ato raste kur nuk mund të identifikohet ankuesi. Për rrjedhojë duke mos patur nevojë për një viktimë, nuk lind nevoja as për të identifikuar një krahasues. Duke qenë se, paligjshmëria e sjelljes është aq flagrante, standardi të cilit Komisioneri i është referuar, është ai i një “standardi të vërtetë” që duhet të ekzistojë në një shoqëri demokratike, siç kërkohet nga pika 2, e nenit 3, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Duke iu referuar çështjes Delfi AS kundër Estonisë<sup>7</sup>, vërejmë se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut parashtrori se: *“...duhet të mbahet përgjegjësi, në parim, për gjuhë shpifëse ose të llojeve të tjera të paligjshme dhe kjo të përbëjë mjet efektiv ndaj cënimit të personalitetit të individëve”*.

Në çështjen Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë, GJEDNJ-ja mban qëndrimin se, në disa raste ndërhyrja në lirinë e shprehjes është e domosdoshme në një shoqëri demokratike, për shkak të mbrojtjes së reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve.

Lufta kundër intolerancës dhe diskriminimit janë thelbësore në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejta dhe liri që përbëjnë një nga bazat e shtetit. Dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, qëndrojnë në themel të shtetit tonë. Kushtetuta, sanksionon detyrimin e shtetit, jo vetëm të mos i cënojë ato, por të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të garantuar mos cënimin e tyre nga privatët, pra shteti duhet të marrë të gjitha masat për t’i mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët.

Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se debati i shëndoshë e i hapur në një shoqëri pluraliste nuk mund të arrihet pa ruajtje të fortë dhe të gjithanshme të së drejtës së lirisë së shprehjes. Sipas standardeve përkatëse të Këshillit të Evropës, edhe kufizimet nga e drejta synojnë ti shërbejnë interesit më të mirë të një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Qasja e traktateve përkatëse, kërkon të krijojë hapësirë për një angazhim kritik dhe për debat ndërmjet grupimeve me qëndrime të ndryshme dhe të pozicionuara ndryshe në shoqëri, dhe të sigurojë në të njëjtën kohë se hapësira mbetet tolerante dhe nuk ndikohet nga urrejtja.

Në nenin 3/8 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Gjuha e urrejtjes’ është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes të bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji”*.

<sup>7</sup> Delfi AS kundër Estonisë, çështja nr. 64569/09, Vendimi datë 10.10.2013, Nota Informative 167.

Në emisionin e datës 14.12.2020, S.N ka theksuar, duke veçuar, se gjatë protestave të zhvilluara në ato ditë, fëmijët që i përkasin komunitetit rom kanë qenë të paguar për të shkatërruar qytetin, ndërkohë që pjesëmarrës në protestat e zhvilluara, ka pasur dhe persona të tjerë, që nuk janë pjesë e komunitetit rom.

Komisioneri vlerëson se, etiketimi i fëmijëve të komunitetit Rom si të paguar dhe shkatërrues të pronës, në mediat vizive kombëtare, nuk ndihmon grupet e pamundura dhe të marginalizuara të shoqërisë që të krijojnë një perceptim pozitiv në shoqëri, përkundrazi mund të ndikojë në mbajtjen e qëndrimeve negative dhe agresive ndaj këtij komuniteti, nga ana e publikut në përgjithësi dhe atij më pak të informuar në veçanti. Përdorimi i deklarimeve të tilla, përmban një kuptim negativ dhe denigruet kundrejt komunitetit rom, duke shfaqur doza diskriminimi dhe përforcon stereotipet e krijuara ndaj pakicës rome dhe i vendos ata në pozita të pafavorshme e përçmuese në raport me pjesën tjetër të shoqërisë.

Në çështjen Feret<sup>8</sup> kundër Belgjikës, GJEDNJ ka bërë interpretime të rëndësishme, nga të cilat citojmë se: *“.....nxitja e urrejtjes nuk nënkupton domosdoshmërisht thirrje për kryerjen e akteve të dhunës apo ndonjë akti tjetër të paligjshëm. Sulmet ndaj grupeve të veçanta të popullsisë të kryera nëpërmjet fyerjes, talljes apo shpifjes, mund të jenë të mjaftueshme për autoritetet për të përligjur trajtim të menjëhershëm dhe efikas kundër shprehjeve raciste, përballë lirisë së shprehjes të ushtruar në mënyrë të papërgjegjshme.....”*.

Komisioneri vlerëson se gjuha e përdorur nga S.N për shkak të racës, reflekton dukshëm një qëndrim të qëllimtë diskriminues në mënyrë të tillë që cënon rëndë parimin e mosdiskriminimit, në zbatim të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe etiketime të tilla ndaj grupimeve të veçanta të popullsisë të kryera përmes fyerjes apo stigmatizimit janë të mjaftueshme për autoritetet për të përligjur trajtim të menjëhershëm dhe efikas kundër shprehjeve raciste përballë lirisë së shprehjes të ushtruar në mënyrë të papërgjegjshme.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë e ka theksuar këtë fakt në çështjen Feryn<sup>9</sup> ku është shprehur se: *“..... mosndëshkimi i një sjelljeje diskriminuese kaq të hapur do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së Direktivës për barazi bazuar në shkaqe raciale”*.

Në çështjen Feret<sup>10</sup> kundër Belgjikës, GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin se: *“.....një ligjëratë e tillë në mënyrë të paevitueshme do krijojë mes publikut – e veçanërisht mes atyre anëtarëve të publikut që nuk janë të mirëinformuar – ndjenja keqkuptimi, madje refuzimi e te disa, edhe urrejtje.....”*.

Rëndësia që merr liria e fjalës për një person publik sjell një përgjegjësi më të madhe, për të treguar më tepër kujdes dhe për të evituar gjuhën që nxit mostolerancën dhe diskriminimin mes publikut. Lufta kundër mungesës së tolerancës dhe diskriminimit janë thelbësore në mbrojtjen e

<sup>8</sup> Feret kundër Belgjikës, Kërkesa nr/15615/07, 16 korrik 2009.

<sup>9</sup> Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding kundër firmës Feryn NV, C-54/07, 10 korrik 2008.

<sup>10</sup> Feret kundër Belgjikës, Kërkesa nr/15615/07, 16 korrik 2009, përkthim i Komisionerit.



të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejta dhe liri që përbëjnë një nga bazat e shtetit. Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se, përhapja e ligjëratave të tilla nëpërmjet televizionit kombëtar përbën një mjet të fuqiqëm të përhapjes së informacionit dhe të ndikimit të publikut. Komisioneri sjell në vëmendje se, nga ana e politikanëve dhe personave publik duhet të bëhet dallimi midis diskutimit politik dhe diskutimit të çështjeve të tjera të interesit publik, duke mos veçuar grupe të marginalizuara të shoqërisë sonë.

Ligji Nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, njeh komunitetin rom në Shqipëri si pakicë kombëtare dhe garanton mosdiskriminimin dhe barazinë e plotë para ligjit<sup>11</sup>.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pavarësisht faktit nëse diskutimi i bërë në emision, nga ana e S.N, nuk mund të ketë patur qëllim të drejtëpërdrejtë nxitjen e urrejtjes (në formën e denigrimit) apo diskriminimin e komunitetit rom, përdorimi i saj ka vendosur në pozita diskriminuese në formën e gjuhës së urrejtjes, anëtarët e këtij komuniteti, pasi përdorimi i një gjuhe të tillë përforcon stereotipe negative, duke fyer kështu komunitetin rom dhe duke mos lejuar perceptimin e tyre shoqëror si anëtar me të drejta të barabarta në shoqërinë shqiptare.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32/1, gërma a) si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 dhe 10 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetasve që i përkasin komunitetit Rom nga ana e S.N, për shkak të racës, në formën e gjuhës së urrejtjes.

---

<sup>11</sup> Neni 2 “1. Ky ligj ka për qëllim të sigurojë ushtrimin e të drejtave specifike të personave që u përkasin një pakice kombëtare, të cilat janë të nevojshme për mbrojtjen e identitetit dallues të pakicave kombëtare, si një përbërës thelbësor i një shoqëri e të integruar dhe që garantojnë mosdiskriminimin dhe barazinë e plotë para ligjit. 2. Në ushtrimin e këtyre të drejtave, personat që u përkasin pakicave kombëtare duhet të respektojnë shtetin ligjor, tërësinë territoriale dhe sovranitetin e Republikës së Shqipërisë.” dhe 3 “1. Pakicë kombëtare është një grup shtetasish shqiptarë që banojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, kanë lidhje të hershme dhe të qëndrueshme me shtetin shqiptar, shfaqin karakteristika dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare ose tradicionale dhe të cilët janë të gatshëm për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar së bashku identitetin e tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional. 2. Në kuptimin e këtij ligji, pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë janë pakicat greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare”.

2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, S.N, të dalë me një deklaratë publike (verbale apo të shkruar) me anë të së cilës distancohet nga përdorimi i një gjuhe të tillë, e cila paragjykon haptazi dhe prek dinjitetin e personave të komunitetit rom.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, S.N, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat konkrete të marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**